



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:043261

Datë: 25.03.2025

Numri i dokumentit: 07042484

P.nr.46/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.J nga fshati ..., rr. "...", komuna Mitrovicë, për shkak te veprës penale *Vjedhja e pyllit* nga neni 349 par. 1 të KPRK-së, i ngarkuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.246/2022 të datës 16.02.2023, jashtë seancës, në mbështetje të nenit 248, par. 1, nën par. 1.4, të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për ndërmjetësim, me datë 25.03.2025, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit Nr. Ref. ND. 46/2025 e datës 25.03.2025, e arritur ndërmjet të pandehurit B.J dhe të dëmtuarës Agjencia Pyjore e Kosovës.

II.HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.246/2022 e datës 16.02.2023.

III.PUSHOHET procedura penale për të pandehurin B.J, nga i ati A... dhe e ëma ..., i lindur me datë ..., me vendbanim në fshatin ..., rr. "...", komuna Mitrovicë, me numër personal ..., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale *Vjedhja e pyllit* nga neni 349 par. 1 të KPRK-së.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.246/2022 të datës 16.02.2023, e ka akuzuar të pandehurin B.J nga fshati ..., Komuna Mitrovicë, për shkak të veprës penale *Vjedhja e pyllit* nga neni 349 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata, me datë 25.03.2025 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me këtë çështje penale, në të cilën i pandehuri ka propozuar që lënda të referohet në procedurë të ndërmjetësimit, përfaqësuesja e palës së dëmtuar është pajtuar që lënda të referohet në procedurë të ndërmjetësimit. Prokurori i shtetit nuk e ka kundërshtuar propozimin që lënda të referohet në procedurë të ndërmjetësimit, pasi që plotësohen të gjitha kushtet ligjore që lënda të referohet në procedurë alternative, të ndërmjetësimit.

Gjykata ka aprovuar propozimin e palëve dhe e ka referuar këtë lëndë penale në ndërmjetësim pasi që me nenin 2, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet në rastet ku parashihet dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim deri në tri (3) vjet, përveç rasteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, e që në rastin konkret për veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri është përcaktuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, kurse me nenin 8, paragrafi 7, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se pranohet marrëveshja në mes palëve për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, në çdo fazë të zhvillimit të procedurës në gjykatë kompetente, apo në një organ tjetër kompetent.

Gjykata është njoftuar nga ndërmjetësuesi se palët, me datë 25.03.2025, kanë arritur pajtimin në ndërmjetësim, ashtu që janë pajtuar që çështja të zgjidhet përmes ndërmjetësimit, të cilën marrëveshje e kanë nënshkruar dhe e njëjta nga ndërmjetësuesi është proceduar në gjykatë për aprovim të marrëveshjes.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, konstatoj se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit, andaj edhe gjykata të njëjtën e aprovoi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Gjykata duke pasur parasysh marrëveshjen e arritur në ndërmjetësimin në mes të pandehurit dhe palës së dëmtuar, e bazuar në neni 357 par. 1, pika 1.3 e lidhur me nenin 229 par. 5 të KPPRK-së, ka vendosur si në dispozitiv të pikës II dhe III të këtij aktvendimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale ka vendosur në bazë të nenit 453 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.46/2023, datë 25.03.2025

Zyrtarja ligjore

Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues

Naim Rekalii

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk lejohet ankesa (neni 229 par. 6 të KPP-së).